

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dronët rusë sjellin luftën deri në Moldavi dhe Rumani
ADRESA	https://dosja.al/bota/dronet-ruse-sjellin-luften-deri-ne-moldavi-dhe-rumani-i514017
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 07:21:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 07:17:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3ab7294538ba89ecec04be3a916065affb2a6ad85ec4f21f4f95e58d7fdb19b1
TEKSTI	ea7e8de880e358b38cac1bc40da4b00822d7494cfa20047ca6b8ca44c84f95b5
PAMJA	e607b86a237063980a2bc27a49f7bdb78247d701140e75b93b0981c00466a5da

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	54bfbb2cf52dd06d4474ac2589539543919bfee911fccd8a1c815616ebaec80
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	ac1c8d986ca8a5982bff13c00b3f40fb9a36fbd6d516390a812a54ba861f1b0b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/54bfbb2cf52dd06d4474ac2589539543919bfee911fccd8a1c815616ebaec80>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

14 ORE ME PARE

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbrasin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

15 ORE ME PARE

Reforma e re territoriale/ Rama përplaset me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj: Qepeni gojën

20 ORE ME PARE

Të shtëna me armë zjarri në Mat/ Gjendet e djegur makina e autorëve, shënjestra ishte Akil Lleshi, makina e të birit u qëllua me 35 plumba

21 ORE ME PARE

"Vetë zot, vetë shkop"/ Ngërçi me pagat e gjyqtarëve, shpërthen Rama: Do nxirrnin dhembët për të shumëfishuar rrogat! KLP e KLGJ, shëmbëlltyra e errët e reformës në drejtësi

Bota

Dronët rusë sjellin luftën deri në Moldavi dhe Ruman

Por tani lufta ruse me dronë po afrohet gjithnjë e më kërcënueshëm pranë dy fqinjëve të Ukrainës: Republikës së Moldavisë dhe Rumanisë.



14 Shtator 2026, 09:17
Nga E.d




Foto ilustruese

Për ukrainasit, lufta ajrore e Rusisë është prej vitesh një realitet i përgjakshëm dhe i hidhur. Nga raketat, bombat ajrore dhe dronët, çdo ditë humbin jetën njerëz në Ukrainë. Në një masë shumë më të vogël, ndikohen edhe fqinjët e Ukrainës në Evropën Qendrore dhe Juglindore, kur raketa dhe dronë depërtojnë në hapësirën e tyre ajrore ose herë pas here rrëzohen në territorin e tyre.

Por tani lufta ruse me dronë po afrohet gjithnjë e më kërcënueshëm pranë dy fqinjëve të Ukrainës: Republikës së Moldavisë dhe Rumanisë. Ndërkohë, pothuajse çdo ditë regjistrohen incidente me dronë në territoret e të dyja vendeve. Shpesh ato shpërthejnë dhe tashmë ka pasur edhe persona të plagosur. Kohët e fundit janë shtuar edhe sulmet ndaj pikave ukrainase të kontrollit kufitar me Republikën e Moldavisë dhe me Rumaninë.

Sulmet janë zgjeruar aq shumë, sa që sipas shumë vëzhguesve nuk mund të flitet më për rastësi. Ata dyshojnë se Kremli synon ta përhapë qëllimisht luftën edhe në dy vendet fqinje të Ukrainës. Një nga shpërthimet më të fundit të dronëve, të martën (08.09.2026), shkaktoi reagime të forta, sepse si pasojë u vonua ngritja e avionit të presidentit ukrainas, me Volodymyr Zelenskyn në bord, nga kryeqyteti moldav Kishinau.

Manovër e qëllimshme?

Çfarë kishte ndodhur konkretisht? Një dron rus i tipit më të ri Geran, i pajisur me motor reaktiv dhe i aftë të fluturojë me shpejtësi deri në 500 kilometra në orë, ishte nisur të martën pasdite vonë nga gadishulli i pushtuar i Krimesë dhe, duke ardhur nga Ukraina, depërtoi fillimisht në hapësirën ajrore të Moldavisë e më pas në atë të Rumanisë. Atje, pas një kthese të papritur, ai u rikthye sërish në hapësirën ajrore moldave. Në veri të vendit, pranë lokalitetit Rișcani, droni u rrëzua në një arë me luledielli dhe shpërtheu. Trajektorja e fluturimit të dronit lë të kuptohet se bëhej fjalë për një manovër të qëllimshme.

Avioni i presidentit ukrainas nuk u "godit për pak", siç ishte raportuar fillimisht në disa media. Droni u rrëzua rreth 160 kilometra në veri të Aeroportit Ndërkombëtar të Kishinaut. Megjithatë, trajektorja e tij kalonte përmes territorit të gjithë Republikës së Moldavisë dhe, për një periudhë të caktuar, kaloi pranë kryeqytetit moldav Kishinau, si edhe më vonë pranë metropolit rumun të Iașit, në verilindje të Rumanisë. Për këtë arsye, hapësira ajrore e Moldavisë u mbyll plotësisht për rreth një orë. Aeroporti i Kishinaut, si edhe aeroporti i qytetit Iași në Ruman, pezulluan nërkohësisht operacionet e fluturimit. Edhe Volodymyr Zelensky, i cili ishte në muinë për në Oslo, mundi të nisei

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

BOTA 14 SHTATOR 2026, 07:21

Analiza e The Economist: Pse
Rusia po e dobëson qëllimisht
monedhën e saj?

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 07:19

BE ka dhënë 1.1 milionë leje
qëndrimi për shqiptarët, në
Gjermani numri arrin rekordin
e 124 mijë

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 07:14

Sa kushton dita e parë e
shkollës? Mesatare rreth 24 mijë

vetëm me vonesë.

Gjithnjë e më shumë incidente

Aspekti më i rëndë i këtij incidenti ishte se ai tregoi edhe një herë se Moldavia mund ta mbrojë hapësirën ajrore të vendit vetëm në mënyrë shumë të kufizuar. Droni u zbulua dhe u ndoq nga sistemet e monitorimit ajror, por nuk ishte e mundur të rrezohej. Sipas të dhënave publike, Moldavia disponon vetëm një numër të vogël raketash kundërajrore polake Piorun, të cilat mund të mbrojnë, në rastin më të mirë, vetëm objekte të caktuara.

Kurse në Ruman, nga baza ajrore e NATO-s në Kogălniceanu, pranë portit të Konstancës në Detin e Zi, u ngritën dy avionë luftarakë. Megjithatë, mbetet ende e paqartë pse ata nuk e rrëzuan dronin, siç ka ndodhur në disa raste gjatë javëve të fundit. Në total, që nga fillimi i gushtit 2026, në Republikën e Moldavisë dhe në Ruman janë regjistruar dhjetëra incidente me dronë. Këto përfshijnë kryesisht shkelje të hapësirës ajrore, por edhe rrëzime, shpërthime, gjetje mbetjesh të dronëve dhe, në Ruman, disa raste të rrëzimit të tyre nga forcat ushtarake. Vetëm në Republikën e Moldavisë, sipas të dhënave zyrtare, gjatë muajit gusht u rrëzuan 17 dronë, aq sa gjatë gjithë vitit të kaluar së bashku.

Të vdekur në pikën e kontrollit kufitar

Incidenti më i fundit ndodhi natën e së mërkurës (09.09.2026) në pikën kufitare ukrainase të Starokosaçes, në juglindje të Republikës së Moldavisë. Kalimi kufitar u dëmtua nga një sulm me dronë dhe ndodhet rreth një kilometër larg territorit moldav. Si pasojë e sulmit, dy persona humbën jetën, ndërsa dy të tjerë u plagosën, mes tyre edhe një shtetas i Republikës së Moldavisë. Moldavia i dënoi ashpër sulmet me dronë. Presidentja Maia Sandu deklaroi të mërkurën se lufta e Rusisë tashmë ka arritur deri në kufirin e Moldavisë. "Është e vështirë të kuptohet se si, përballë këtij realiteti, ende ka zëra që përipiqen t'i bindin moldavët se Rusia nuk është agresori ose se lufta në fqinjësinë tonë nuk na prek", tha Sandu.

Edhe kryetari i Parlamentit të Moldavisë, Igor Grosu, shkroi në Facebook se bëhet fjalë për incidente që "nuk mund t'i konsiderojmë më si diçka të largët". Sipas tij, kërcënimi që vjen nga Rusia nuk është një "fantazmë" dhe as propagandë. "Ai është një realitet i përditshëm", theksoi Grosu.

Operacion i planifikuar

Eksperti moldav për çështjet ushtarake dhe të sigurisë, Rosian Vasilo, ish-shëf i Policisë Kufitare të Moldavisë, shkroi në Facebook pas rrëzimit të fundit të një droni në Republikën e Moldavisë: „Ky është një operacion i planifikuar i shtetit agresor.”

Ai iu referua, ndër të tjera, trajektore të pazakontë të fluturimit të dronit, veçanërisht kthesës së papritur që e riktheu atë në hapësirën ajrore moldave. Vasilo thekson, se „ne nuk mund ta shohim më hapësirën tonë ajrore të ndarë nga ajo e Ukrainës dhe e Rumanisë. Ukraina, Republika e Moldavisë dhe Rumania përbëjnë tashmë një hapësirë të ndërlidhur operationale sa u përket kërcënimeve ajrore dhe ndikimit të tyre në ndërlidhjen rajonale.”

Rumania deri më tani nuk ka reaguar publikisht ndaj incidenteve më të fundit. Megjithatë, qeveria rumune kishte ndërmarrë që në korrik një ndryshim të rëndësishëm politik dhe ushtarak: pas një periudhe të gjatë përmbajtjeje, ajo filloi të rrëzojë dronë që depërtojnë në hapësirën ajrore rumune. Gjenerali i pensionuar rumun Virgil Bălăceanu, një ekspert i njohur dhe komentator i shpeshtë në mediat rumune, i bëri thirrje udhëheqjes së Rumanisë të përshpejtojë forcimin dhe zgjerimin e mbrojtjes ajrore të vendit. Edhe Bălăceanu është i mendimit se incidenti me dronin të martën nuk ishte një rastësi, por një manovër e qëllimshme.

Instituti amerikan Institute for the Study of War (ISW), një nga qendrat më të njohura kërkimore për luftën ruse kundër Ukrainës, shkroi pas incidentit me dronin të martën se nuk ka prova të qarta që shkelje të tilla të hapësirës ajrore të jenë të qëllimshme, megjithatë, sipas ISW-së, mund të thuhet se Rusia përfiton nga incidentet të tilla. Veçanërisht përdorimi i modeleve më të reja dhe më të shpejta të dronëve rusë Geran synon të "testojë më tej sistemet e mbrojtjes së NATO-s dhe të Republikës së Moldavisë, si edhe reagimin e të gjithë Aleancës së NATO-s". Edhe nëse nuk mund të provohet se depërtimet në hapësirën ajrore të Moldavisë dhe Rumanisë janë të planifikuara qëllimisht, ekspertët e ISW-së vlerësojnë se Rusia i shfrytëzon këto incidente për të vëzhguar dhe vlerësuar aftësitë mbrojtëse të vendeve fqinje dhe të NATO-s./DW

dronët rusë

rumani

moldavi

Sondazh

SHKROJTES: MESA QALIBIST Q' NDIJE
lekë për një fëmijë...

më të klikuarat

"Qepeni gojën"/ Debate për shkrimin e bashkisë, Rama përplasat me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj! Qytetarët largohen nga takimi

Zgjedhjet në Suedi/ E djathta ekstreme synon pushtetin për herë të parë

Detaje nga të shtënat me armë në Mat/ Reth 30 gëzhoja gjenden në vendingjarje, pronarët e mjetit të djegur sapo ishin kthye nga Italia



"U kuturisën të nxirrnin urdhër"/ Përplasja për pagat, shpërthen Rama: KLP e KLGJ, shëmbëlltyra e errët e reformës në drejtësi

insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvernec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

Moti

Powered by tomorrow.

Bota

14 Shtator 2026, 09:05

VIDEO/ Aksident i rëndë në Turqi, autobusi përfshihet nga flakët pas përplasjes! Humbin jetën 2 persona

Pamje TURQI- Një aksident i rëndë rrugor ka ndodhur në Turqi, ku një autobus është përplasur me barrierat e pages&e...

Trump i thotë Kievit t'i ndalë sulmet ndaj naftës ruse, teksa dronët rusë godasin pranë kufirit polak

Bota

14 Shtator 2026, 08:56

"Ne e urrejmë frikën"/ 10 mijë njerëz dalin në rrugë kundër kartelit Sinaloa (VIDEO)

Bota

14 Shtator 2026, 08:38

Pas sulmeve në Hormuz dhe mbylljes së tubacionit në Arabinë Saudite, rriten çmimet e naftës

Bota

14 Shtator 2026, 08:32

Zgjedhjet në Berlin mes radikalizimit të politikës

Bota

14 Shtator 2026, 07:53

Bota

14 Shtator 2026, 07:46

Droni rus godet trenin e pasagjerëve drejt Varshavë

Foto ilustruese Një dron rus goditi një tren pasagjerësh që udhëtonte midis Kievit dhe Varshavës në Ukrainë. Sipas n...

Analiza e The Economist: Pse Rusia po e dobëson qëllimisht monedhën e saj?

Bota

14 Shtator 2026, 07:21

"SHBA nuk mund të mbetet pas Kinës"/ Trump kundër kufizimit të AI: Kush fiton inteligjencën artificiale, fiton mbi të gjithë

Bota

13 Shtator 2026, 22:14

VIDEO/ Përfshihet nga zjarri një pyll në Spanjë, plagosen dy persona

Bota

13 Shtator 2026, 20:26

Kthesa strategjike pas përmbytjeve në Marok, synohet që 60% e ujit të pijshëm të sigurohet nga deti

Bota

13 Shtator 2026, 18:32

MË SHUMË





"Mërgata të na bashkohet, ndryshe
Atdheu do të rrejet pa shqiptarë"
Aktivisti Arben Kola: Nga nesër mbledhja
në sheshin "Skënderbeu" në orën
18:30

**Aktivisti Arben Kola: Nga nesër mbledhja në sheshin
"Skënderbej" nis në orën 18:30**

 [Shiko video te tjera](#)

Erplasjet e rrethit me
banorët e Poliçanit, qytetari:
U soll si sulltan, u tha qepeni
gojën

Dita e 106-të e protestës/ Nis
marshimi drejt
Kryeministritë: Shqipëria
kërkon revolucion

Rama në Berat: Çfarë lidhje
ka distanca?, ndryshon vetëm
drejtimi vendor

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.